

# Azilkërkuesit në Shqipëri

## Viti 2021

**Tiranë, më 05 korrik 2022:** Në 2021 rezultojnë 2.533 azilkërkues në Shqipëri, duke pësuar rritje me 13,5 % krahasuar me 2020.

Azilkërkuesit me origjinë nga Afganistani zënë 98,6 % të azilkërkuesve gjithsej në 2021 dhe rezultojnë 2.498 persona.


Në 2021 rezultojnë 711 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 68,1 %, krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vittit 2021 rezultojnë të janë 724 persona, të cilët kanë humbur shtetësinë shqiptare, duke pësuar rritje me 41,1 %, krahasuar me vitin 2020.

## Azilkërkuesit në Shqipëri

Azilkërkuesit në Shqipëri, referuar Drejtorisë së Azilit dhe te Huajve, si dhe Shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, rezultojnë 2.533 persona në 2021. Duke analizuar vendin e origjinës së azilkërkuesve në 2021 kuptojmë se, shumicën e rasteve e përbëjnë ato me origjinë nga Afganistani me 2.498 azilkërkues, duke vijuar me 19 azilkërkues nga Siria.

**Fig. 1 Azilkërkuesit sipas vendeve kryesore të origjinës, 2018 - 2021**




Burimi: Drejtoria e Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme

**Për publikim 05 korrik 2022**

*Vijon*

Duke parë kërkesat për azil sipas muajve, kuptojmë se piku i aplikimeve kanë qenë në muajt Shtator-Nëntor, të cilët përbëjnë 76,4 % të azilkërkuesve gjithsej. Kjo si pasojë e situatës politike në Afganistan.

**Fig. 2 Kërkesat për azil sipas muajve, 2019 - 2021**



Burimi: Drejtoria e Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme

Gjatë 2021 rezultojnë 7 vendime pozitive për dhënie të statusit të mbrojtjes plotësuese për azilkërkuesit, nga këto raste 4 i përkasin shtetasve nga Afganistani dhe 3 Siria.

#### Fitimi dhe lënia e shtetësisë Shqiptare

Në 2021 rezultojnë 711 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 68,1 %, krahasuar me vitin 2020. Po të analizojmë të dhënat sipas gjinisë, vëmë re se 443 persona që kanë fituar shtetësinë Shqiptare janë meshkuj dhe 268 femra. Vihet re një dominim i meshkujve me 62,3 %.


Në 2021, rezultojnë 724 persona të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, duke pësuar rritje me 41,1 %, krahasuar me vitin 2020. Po të analizojmë të dhënat sipas gjinisë, vëmë re se 403 persona që kanë lënë shtetësinë Shqiptare janë femra dhe 321 meshkuj. Vihet re një dominim i femrave me 55,7 %.

**Tab. 1 Fitimi dhe lënia e shtetësisë Shqiptare**

Viti	2017	2018	2019	2020	2021
Fitim shtetësie	316	345	485	423	711
Lënia shtetësie	651	640	741	513	724

Burimi: Drejtoria e Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme


Duke analizuar vendin e origjinës të personave që kanë fituar shtetësinë Shqiptare kuptojmë se shumicën e rasteve ose 73,8 % e përbëjnë ato me origjinë nga Kosova, Turqia me 7,3 %, Siria me 5,9 %.

**Fig. 3 Fitimi i shtetësisë Shqiptare sipas vendit të origjinës, 2021**

Burimi: Drejtoria e Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme

Gjatë 2021 grupmosha që dominon është 30-39 vjeç me 31,5% të personave që kanë fituar shtetësinë Shqiptare e ndjekur me grupmoshën 20-29 vjeç dhe 40-49 vjeç me 22,9% dhe 19,3% respektivisht.

Për personat që kanë lënë shtetësinë Shqiptare grupmosha që dominon është 30-39 vjeç me 38,8% e ndjekur me grupmoshën 40-49 vjeç dhe 20-29 vjeç me 23,9% dhe 18,6% respektivisht.

**Fig. 4 Fitimi dhe lënia e shtetësisë Shqiptare sipas grup-moshës, 2021**

Burimi: Drejtoria e Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë, Ministria e Brendshme

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit vjetor për azilkërkuesit në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve për azilkërkuesit në Shqipëri sipas gjinisë, muajit të aplikimit, vendeve të origjinës, si dhe numrin e individëve që kanë marrë dhe lënë shtetësinë Shqiptare.

Të dhënat mbi Azilkërkuesit dhe fitimit ose lénies së shtetësisë në Shqipëri sigurohen nga Drejtoria e Azilit dhe te Huajve, si dhe Shtetësisë, në Ministrinë e Brendshme.

## Përkufizime:

**Azil** është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese.

**Azilkërkues** është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë.

**Aplikim për azil** është kërkesa zyrtare e të huajit ose personit pa shtetësi para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas Konventës së Gjenevës së OKB-së, "Mbi statusin e refugjatit". Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përvèç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.

**Kërkesë për azil** është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdolloj mënyre e në çfarëdo kohe përparrë autoritetëve kompetente, në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konvantave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.

**Shtetësia shqiptare** fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat ligjore për shtetësinë shqiptare, të cilat respektojnë normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë, të pranuara nga Republika e Shqipërisë.

**Shtetësia shqiptare fitohet** me: a) lindje; b) natyralizim; c) birësim

**Fitimi e shtetësisë** fitohet nga një i huaj që ka paraqitur kërkesë për marrjen e shtetësisë shqiptare, në rast se plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

**Lënia e shtetësisë shqiptare** nënkupton se pasja e shtetësisë shqiptare merr fund sipas kérkesës së personit, kur ai plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

**Shtetas i huaj** është personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe ka shtetësi të huaj.

**Person pa shtetësi** është personi që nuk gjëzon shtetësinë e asnjë shteti për shkak të mungesës së një lidhjeje të qëndrueshme juridike ndërmjet tij dhe një shteti.

**Refugjat** është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsyе të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrëthanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës.

**Shtet apo vend i origjinës** është shteti, shtetësinë e të cilit mban kërkuesi ose në rastin e personave pa shtetësi, vendbanimi i zakonshëm i mëparshëm.

**Status i mbrojtjes plotësuese** është njohja në Republikën e Shqipërisë e të huajt ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese. **Status i refugjatit** është njohja në Republikën e Shqipërisë e shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat.